



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18.02.2025 | Nr: 107 | Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN  
NR.19 ID, DATË 17.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË  
KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË  
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 18.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

**SUBJEKT:** Z. Klevis Hysa  
Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Z. Elio Muça  
Kryeinspektor, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

**OBJEKT:** Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

**K O N S T A T O J :**

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 17.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail. Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 19 ID, në datën 17.02.2025.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:



*“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve. Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare e Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si:*

- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”.

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Z. Klevis Hysa, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive;
  - Z. Elio Muça, Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**